

Anëtarët e komisionit për raste të rënda në Tyingen

Kryetari i Komisionit për peticione

Zoti Michael Heym
Parlamenti i Landit Federal Tyingen
Rr. Jürgen-Fuchs-Str. 1
99096 Erfurt
Numri i telefonit: 0361 3772222
Numri i telefaksit: 0361 3772520
Emaili: Heym@cdu-landtag.de

Referenti për çështje të migracionit pranë TMMJV

Zonja Mirjam Kruppa
Rr. Werner-Seelenbinder-Str. 5
99096 Erfurt
Numri i telefonit: 0361 5735 111 700
Numri i telefaksit: 0361 5735 111 699
Emaili: BIMF@tmmjv.thueringen.de

Parlamenti i Rretheve Administrative në Tyingen

(Thüringer Landkreistag)
Zoti Uwe Lippold
Administrata e rrethit „Kyffhäuserkreis“
Numri i telefonit: 03632 741 625
Numri i telefaksit: 03632 741 888 15
Emaili: u.lippold@kyffhaeuser.de

Kisha romake-katolike

Zoti Winfried Weinrich
Kryetari i Zyrës Katolike në Tyingen
Sheshi Hermannsplatz 9
99084 Erfurt
Numri i telefonit: 0361 657 22 14
Numri i telefaksit: 0361 657 22 17
Emaili: kath.buero@bistum-erfurt.de

Këshilli rajonal i mjekëve

Zoti Helmut Krause (mjeku i diplomuar)
Lerchensiedlung 4
98693 Ilmenau
Numri i telefonit: 03677 871 904
Emaili: Ilmkrause@gmx.de

Lidhja e Lirë për Mirëqenie Sociale

(Liga der Freien Wohlfahrtspflege)
Zonja Maike Röder
Këshilltare për çështje të migracionit pranë kishës protestante
Rr. Schillerstraße 6
99817 Eisenach
Numri i telefonit: 03691 260 355
Telefoni mobil: 0173 327 24 33
Emaili: m.roeder@diako-thueringen.de

Kisha protestante

Zoti Hanfried Victor (famullitar në pension)
Rr. Falkenweg 10
99891 Bad Tabarz
Numri i telefonit: 036259 61 083
Emaili: hanfried.victor@t-online.de

Lidhja e Komunave dhe Qyteteve

(Gemeinde- und Städtebund)
Zoti Peter Neuhäuser
Drejtori i zyrës për çështje të qytetarëve pranë administratës së qytetit Erfurt
Rr. Bürgermeister-Wagner-Str. 1
99084 Erfurt
Numri i telefonit: 0361 655 77 10
Emaili: buergeramt@erfurt.de

Kjo fletushkë ju informon për HFK. Kjo nuk ju transmeton të drejtat dhe nuk zëvendëson këshillin juridik.

Dëftues botimi

Botues: Referenti për çështje të integritit, migracionit dhe për refugjatë
Ministria e Tyingen-it për Migracion, Drejtësinë dhe Mbrojtjen e Konsumatorëve (TMMJV)
Rr. Werner-Seelenbinder-Straße 5
99096 Erfurt

www.thueringen.de

Gestaltung: design_idee_büro_für_gestaltung, Erfurt

Foto: psdesign1/Fotolia.com

Druck: www.viaprinto.de

Komisioni për raste të rënda në Tyingen



Çfarë bën komisioni për raste të rënda?

Komisioni për raste të rënda vendosë lidhur me atë, se a mund ta marrin lejen e qëndrimi refugjatët, të cilët përfundimisht janë të detyruar për ta lëshuar vendin.

Në situata të caktuara për ata kjo paraqet një rast të papranueshëm, nëse ata nuk mund të mbeten në Gjermani. Rastet e tilla urgjente humanitare ose personale i verifikon komisioni për raste të rënda në Tyingen (HFK).

Në qoftë se HFK vjen deri në përfundim se janë paraqitur raste të tilla, atëherë ajo kërkon nga Ministria e Tyingen-it për Migracion, Drejtësinë dhe Mbrojtjen e Konsumatorëve (TMMJV), që të urdhërohet lëshimi i një leje qëndrimi.

Përderisa HFK merret me shqyrtimin e një çështje, nuk do të pasoj ndonjë dëbim me dhunë jashtë vendit.

Kryetare e komisionit për raste të rënda është Sekretarja e shtetit në Ministrinë e Tyingen-it për Migracion, Drejtësinë dhe Mbrojtjen e Konsumatorëve (TMMJV). Të gjithë anëtarët e HFK janë përgjegjës vetëm ndaj ndërgjegjes së tyre. Ata janë të detyruar që të ruajnë gjërat në mënyre sekrete.

HFK i merr vendimet në seanca jo publike dhe pa prezencën e personave në fjalë.

Ju mund të shpresoni në HFK, nëse

- ju banoni në Tyingen
- ju jeni përfundimisht i detyruar që ta lëshoni vendin
- keni arsye urgjente personale apo humanitare për të qëndruar dhe
- mund të caktohet një prognozë pozitive për ju lidhur me çështjen e integritimit.

Kujt mund t`i drejtoheni ju?

Vetëm anëtarët e HFK mund t`ia paraqesin komitetit rastet përkatëse. Për këtë arsye ju duhet t`i drejtoheni njërit prej anëtarëve që ndodhen në anën e pasme të fletës. Para kësaj ju duhet të informoheni gjerësisht dhe të konsultoheni personalisht, p.sh. nga ana e një zyre për këshillime për migracion.

Çfarë duhet të keni parasysh?

Është me rëndësi që ju të paraqitni arsyet tuaja personale dhe humanitare, të cilat e arsyetojnë qëndrimin tuaj të mëtejshëm. Ju duhet të tregoni gjithashtu se si jeni integruar në shoqërinë e këtushme.

Këto janë p.sh. të dhënat përsa i përket

- arsyeve, pse keni hyrë brenda vendit
- qëndrimin tuaj të deritanishëm
- situatës suaj familjare
- gjendjes suaj shëndetësore
- gjendjes suaj ekonomike
- shkollimit tuaj / profesionit tuaj
- angazhimit tuaj shoqëror
- aftësisë suaj të flisni gjuhën gjermane

Ju këto aspekte duhet t`i dëshmoni p.sh. me dokumente.

www.thueringen.de

Kur nuk do të ketë kërkesa juaj ndonjë sukses, apo pak shans për sukses?

Disa rrethana të caktuara përjashtojnë mundësinë e angazhimit të HFK-së, respektivisht shkaktojnë që të duket e pa mundur zhvillimi i një procedure të suksesshme. Kjo mund të ndodhë posaçërisht në rast se,

- ju paraqitni vetëm arsye të cilat duhet të verifikohen nga Enti Federal për Migracion dhe Refugjatët (Bundesamt für Migration und Flüchtlinge)
- ju e keni kryer ndonjë vepër serioze penale
- është caktuar data konkrete për dëbim apo
- aktualisht jeni duke e zhvilluar të ashtuquajturën „Procedurën e Dublin-it“.

Ka edhe arsye të tjera të përjashtimit. Këto mund t`i gjeni në nenin 5 të Rregullores së Tyingen-it për komisionin për raste të rënda (*HärtefKV TH*).